



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.11.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. ... vijojmë me përgjigjet për pyetjet e ngritura gjat mbledhjes së djeshme dhe për pyetjet që i kemi dërguar ministris me e-mail.
2. Shqyrtimi në parim i projektligjeve të Paketës Fiskale.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Antoneta Dhima, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Suzana Topi, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Ryci, Korab Lita, Ylli Shehu, Eljo Hysko

Mungojnë:

Edlira Hyseni, Ervin Bushati

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Znj. Anila Denaj, Ministre

Z. Elton Haxhi, Zv/Minister i Financave dhe Ekonomisë;

Z. Nikolla Lera, Drejtor I Pergjithshem, Drejtoria e Pergjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

Znj. Mimoza Dhembli, Drejtor I Pergjithshem, Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit;

Z. Endrit Lami, Drejtor, Drejtoria e Politikave Makroekonomike

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Meqenëse është kuorumi, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Sot do të vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve të ngritura gjatë mbledhjes së djeshme, të cilat i kemi dërguar në ministri me *email*. Sot ministrja do të përgjigjet, duke iu referuar pyetjeve një e nga një. Për pyetjet e ngjashme besoj se do të jepni një përgjigje të përmbledhur. Në orën 11:45 do ta mbyllim këtë mbledhje dhe në orën 17:00 do të zhvillojmë seancën për shqyrtimin në parim të projektligjeve të paketës fiskale.

Zonja Ministre, fjala për ju.

Anila Denaj – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në vijim të diskutimit të djeshëm, por edhe në përgjigje të pyetjeve parashtroj si më poshtë:

Jepni argumentet pse rritja e pritshme e të ardhurave nga tatimet, doganat dhe kontributet, krahasuar me vitin 2018, përgjysmohet? Për vitin 2019 u projektuan të arkëtoheshin 325 miliardë lekë të ardhura nga tatimet dhe doganat.

Projeksioni i të ardhurave u dizenuara me këto supozime:

Së pari, rritja ekonomike të ishte me plus 4,2%; rritja e indeksit të çmimeve me plus 2,1%; koeficienti i elasticitetit 90% dhe, bazuar në këta parametra, efekti në rritjen e të ardhurave nga rritja nominale të ishte 11,7 miliardë lekë; efekti në rritjen e të ardhurave nga indeksi i çmimeve 6,23 miliardë lekë; efekti total i projektuar nga këta dy faktorë 18 miliardë lekë.

Sipas të dhënave rritja nominale dhe indeksi i çmimeve në shifra, të ndryshme këtë vit, kanë krijuar diferencë me minus 2,8 miliardë lekë, kjo në raport me rritjen ekonomike, si efekt i menjëhershëm në ndryshimin e të ardhurave.

Elementi tjetër (këtu po grupoj disa përgjigje, pasi kanë lidhje me kursin e këmbimit) ka të bëjë me kursin e këmbimit, i cili ka ndikuar në efektin e uljes së të ardhurave të parashikuara për vitin 2019.

Në fillim të vitit 2019 u llogarit se importet e taksueshme dhe tatimet do të gjeneroheshin, duke u bazuar në kursin e këmbimit të lekut me euron në 126,5 lekë. Në fakt, kursi mesatar i këmbimit për periudhën 10-mujore të vitit 2019 ka qenë 123,53 lekë. Ulja e kursit të këmbimit ka prodhuar një efekt negativ prej 1,9 miliardë lekësh, ndërkohë që efekti i pritshëm deri në fund të vitit është menduar të jetë me minus 2,5 miliardë lekë.

Elementi i tretë që ka ndikuar në këtë përgjysmim, sipas parashikimeve, ka të bëjë me efektin e çmimeve ndërkombëtare të mineraleve, me naftën bruto dhe nënproduktet e saj, me kromin dhe bakrin. Bazuar te publikimet ndërkombëtare, çmimi i naftës bruto, për efekt të llogaritjes së detyrimeve doganore nga importi dhe eksporti i saj dhe nënprodukteve të tjera, ishte parashikuar të rritej me rreth 28%, krahasuar kjo me vitin 2018, ndërkohë që rezultoi me ulje në minus 9%. Kjo ulje ka prodhuar një efekt prej 1,3 miliardë lekësh minus.

Së katërti, ka disa përjashtime ligjore të paparashikuara në llogaritjen e të ardhurave të buxhetit me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sikurse e dini është hequr TVSH-ja për inputet dhe për makineritë bujqësore, e cila ka sjellë një impakt, të cilin e përmenda edhe dje, me minus 1,2 miliardë lekë dhe i pritshmi me minus 1,5 miliardë lekë.

Lidhur e lojërat e fatit, për shkak të amendimit të ligjeve të lojërave të fatit në fund të vitit 2019...

Arben Ahmetaj – Më falni, zonja Ministre, lidhur me të ardhurat, unë lexoj se një nga deputetët të ka bërë një pyetje për sa i përket krahasimit bazë me bazë me vitin e mëparshëm, duke hequr efektin shtesë të dividendit dhe duke marrë parasysh të dyja efektet shtesë të akcizës, efektit nga rritja e pagës minimale dhe efekti i rritjes së pagave në sektorin publik. Unë dua që të ndalojmë një sekondë këtu. Ndërkohë, dua të ndalojmë edhe te krahasimi i efekteve të kursit të këmbimit vit pas viti, si dhe te çmimi i referencës, bazik i brendit apo i shumicës për naftën.

Anila Denaj – E kam në vijim këtë përgjigje.

Unë po përpiqem të përmbledh disa përgjigje të pyetjeve që lidhen me të ardhurat. Sigurisht, detajet lidhur me pyetjet do t'i diskutojmë kur të shkojmë te pyetja përkatëse, siç është rasti i kursit të këmbimit.

Më lejoni të kthehem tek elementi i pestë, sepse në vijim do të jetë edhe efekti i dividendit, por edhe efekti i rritjes së pagave. Më pas, sigurisht që kolegët e mi, konkretisht zoti Niko Lera, i cili ka një peshë të rëndësishme në parashikimin e të ardhurave për vitin e kaluar, mund të shtojë më tepër detaje pas përfundimit të kësaj pike nga unë.

Nëse i përmbledhim deri tani tri efektet, ato ishin: kursi i këmbimit, efekti negativ në raport me parashikimin e rritjes ekonomike; çmimet ndërkombëtare të mineraleve, përjashtimet që lidheshin me TVSH-në, në raport me inputet dhe me makineritë bujqësore, si dhe lojërat e fatit, pa u futur shumë në detaje, sepse efektin e tyre e dimë, sepse e kemi përmendur më parë, që në vlerë monetare shkon diku te minus 0,4 miliardë lekë.

Elementi tjetër ka të bëjë me efektin nga ndryshimi i skemës së TAP-it, i cili ka sjellë një ndryshim prej 3 miliardë lekësh. Ndërkohë, është reduktuar në një masë më të madhe kërkesa për rimbursim, e cila duhej të jepej në një kohë të dytë. Efekti total negativ nga faktorët e mësipërm është minus 12 miliardë lekë.

Kthehemi tek efektet pozitive, sepse efektet negative sapo i thamë. Sigurisht, unë e përmenda edhe dhe efektin pozitiv të dividendit, i cili, në raport me parashikimin, është me plus 4 miliardë lekë. Në kuadrin makro, efekti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e thashë dhe efektin pozitiv të dividendit, megjithatë e përsëris se efekti pozitiv, tej planifikimit, është me plus 4 miliardë lekë. Në kuadrin makro, efekti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është me plus 4 miliardë lekë mbi parashikimin për dividendin. Në kuadrin makro efekti, gjithsej në të ardhura, nga faktorët e njohur është minus 5 miliardë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E përmenda edhe dhe: efekti ishte 11, parashikimi ishte 7 dhe, detyrimisht, diferenca është me shtesë nga parashikimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Lera.

Niko Lera – Arkëtimet nga dividendi kanë qenë në nivelin 2,5-3 dhe 3,5 miliardë lekë. Në vitin 2018 ishte 3,5 miliardë lekë. Për vitin 2019 ne planifikuam 3,5, që ishte rrjedhja

normale, plus diferencën prej 3,5-4, pra planifikuam 7 miliardë lekë tatim mbi dividendin. Domethënë, në skenarin e buxhetit, që u miratua në Kuvend, 7 miliardë ishin të planifikuara. Në fakt, u arkëtuan 11 miliardë lekë, që do të thotë se faktori pozitiv, tej planifikimit, ka qenë diferenca prej 4 miliardë lekësh.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Pyetja ime ishte për ministren, megjithatë mund ta jepni edhe ju përgjigjen e pyetjes lidhur me efektin *one off* të të ardhurave. *One off*-i në traditën e dividendit në maksimumin e tij është 3,5.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prisni një sekondë, zoti Lera, sepse do të keni mundësi të flisni gjithë ditën në përgjigje të pyetjeve të deputetëve! Pra, traditën mesatare po e marrim 3,5. Të ardhurat në 9-mujorin e parë të vitit për shkak të *one off*-it janë 11 pikë, që do të thotë se në *one off* janë gati 8 miliardë lekë, që do të thotë se nuk kanë qenë dhe mundësia që të mos jenë është shumë e madhe. Arsyeja pse ju pyeta është për të pastruar bazën dhe për të kaluar tek ajo, që iu referua ministrja, për 2,8 miliardë lekëshin lidhur me efektin e diferencës së rritjes nominale, si dhe për të parë efektin e administratës, pra bazë me bazë. Kjo është arsyeja. Pra, a ishte 7,6 miliardë lekë, në krahasim me traditën?

Niko Lera – Sikurse e thashë, tradita ka qenë nga 2,5 deri në 3,5, ndërkohë që ne planifikuam 7 miliardë...

Arben Ahmetaj –Më falni, një sekondë! Ju lutem, mos e përsërisni më, sepse të gjithë njerëzit po ju ndjekin me shumë vëmendje! Ajo që unë po ju them, në normalitetin e metodologjisë së planifikimit të të ardhurave, të cilën e kemi vënë me vite në relacion dhe ju me korrektesë e keni shkruar, shkon rreth 6% rritje, apo nuk është kështu normalisht? Pra, është 6,2 që merr parasysh nominalen, merr parasysh “*task reach*” për të gjitha ndryshimet fiskale, merr parasysh edhe efektin e administratës. E gjithë formula, së cilës në i jemi referuar, ka një emër teknik dhe shkon te 6,2, por kjo nuk ka rëndësi, sepse nuk do të tregojmë këtu. Arsyeja e planifikimit të dividendit nga 3,5 në rastin më të mirë që shkon në 7, që është dyfishi, ka një arsye që është në *one off*. Pra, dyfish-i u bë trefish, që do të thotë se duhet pastruar. Në logjikën që ne po diskutojmë, komisionit, si monitorues, i takon me ligj të dijë më shumë detaje nga Ministria e Financave, e cila është përgjegjëse për mbledhjen e të ardhurave, ndaj mos iu refero planifikimit, sepse është tjetër histori nëse do t’i referohemi planifikimit. Pra, kemi efektin *one off*, që është gati më pak se 8 miliardë lekë. Ajo që unë kërkova nga ju është që ta pastroni këtë

pjesë për të bërë krahasimin bazë me bazë, në mënyrë që të na ndihmojë, kur të diskutojmë për të ardhurat për vitin tjetër. Kaq.

Niko Lera – Dua të sqaroj diçka. Ministria Denaj në përgjigjet e saj, po argumentonte deviacionin nga plani. Pra, ajo këtë po sqaronte. Ndërkohë, për pyetjen tuaj, lidhur me pastrimin e bazës nga *one off*-i, ne tashmë e kemi bërë. Po të shikoni tabelat e projeksioneve të buxhetit, do të vini re se ne kemi planifikuar 6 miliardë *one off*, të cilat i kemi zbritur nga baza e vitit 2019. Pra, janë 11 miliardë lekë tatim dividendi, minus 6, që ne i kemi parashikuar për vitin tjetër, dhe fluksi i tatimit mbi dividendit do të jetë 5 miliardë. Pra, nga 3,5 që ishte me tarifën 15%, ne parashikojmë rritje me tarifën e ulët 8%.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Zoti Lera, ajo që po thosha unë është tjetër gjë.

E para, deputetët kanë bërë pyetje në referencë të efektivitetit të administratës që do të thotë se pastrohen në *one off*, që janë falë një politike, e cila nuk është politikë aktive fiskale, por është politikë pasive fiskale, për të arritur në një bazë të pastër, për t'i krahasuar vitet me njëra-tjetrën, si dhe për të gjykuar lidhur me administratën, sepse në finale drejtorët e administratës raportojnë te kjo ministri, te ministria Denaj. Ndaj, ne jemi duke ndihmuar, për sa na takon brenda tagrit tonë, logjikën për të sqaruar se cilat janë efektet pozitive, cilat janë efektet negative, kjo është baza e pastër, kjo është efienca e administratës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na i tregoni, ju lutem!

Pra, ajo që sapo thashë ka lidhje me të gjithë dividendin, që është 7,6-ta. Na bëni një krahasim, sepse kjo është edhe pyetja e deputetëve. Ndërkohë që ti e bën këtë, ministria mund të vazhdojë me përgjigjet e pyetjeve të tjera.

Dakord, zoti Niko?

Anila Denaj – Sigurisht, është e nevojshme që ne t'ju sqarojmë, por unë po ndjek logjikën e pyetjeve të sjella. Për këtë arsye besoj se pyetja e parë kishte të bënte me diferencën e 11 miliardëve që ne raportojmë në fund të vitit. Pra, lidhur me efektet negative dhe pozitive të 11 miliardë lekëve, sigurisht të parashikuara, e përmenda pak më lart, po e përsëris edhe një herë: efektet negative, që lidheshin me diferencën, në raport me treguesit makroekonomikë, ishin me minus 2,8 miliardë; TVSH-ja e inputeve me minus 1,2; ulja e pagesave të kontraktorëve 3 miliardë, dhe rënia e çmimeve të bursës 1,4 miliardë. Sigurisht, nuk duhet të harrojmë edhe tatimin për lojërat e fatit, të cilat nuk kanë ndikuar vetëm në këtë raport me 0,4 miliardë lekë,

por edhe në raport me të ardhurat nga tatimi për individët. Megjithatë, efekti pozitiv i deidentit është i njohur dhe i theksuar edhe më parë, pastrimin e kemi marrë parasysh, ndërsa vlerën do ta thotë zoti Lera në vijim.

Është shumë e rëndësishme që, kur flasim për të ardhurat, të flasim edhe për rimbursimet, sidomos për rimbursimet e pagesave të TVSH-së, të cilat për vitin 2019 ishin parashikuar në vlerën 19 miliardë lekë, nga 14 miliardë që ishin vitin e shkuar.

Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke e konsideruar pagesën e detyrimit të TVSH-së një pagesë shumë të rëndësishme për ta paguar në kohë, sigurisht që nuk e ka ulur vlerën e parashikuar në buxhet, pra 19 miliardë, duke siguruar një pagesë në kohë të të gjithë detyrimeve të TVSH-së. E theksoj se edhe për vitin e ardhshëm kjo është në vëmendje, duke parashikuar 21 miliardë lekë rimbursim të TVSH-së.

Lidhur me pyetjen e tretë, a ka ndonjë rast tjetër ku të ardhurat faktike nga TVSH-ja rezultojnë në rënie duke e krahasuar me vitin paraardhës, po, ky është viti i parë, nëse marrim parasysh rritjet e disa viteve të fundit. Pra, në vitin 2015 ishte 125,7 miliardë, në vitin 2016 ishte 131,3, në vitin 2017 ishte 139,5, në vitin 2018 ishte 143,4 dhe në vitin 2019 është 140,2. Por, nëse mendojmë se në këta faktorë kanë ndikuar edhe rimbursimet dhe, nëse do të kthehemi te ky realizim, do të llogaritej një shifër 144, 7, pra 1,3 miliardë ose plus 1% mbi 2018.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, a mundem?

Anila Denaj – Po, të lutem.

Arben Ahmetaj – Është e drejtë ajo që thoni, por do të ishte me vlerë të krahasonit TVSH-në bruto, sepse do të na ndihmojë të dimë se si ka qenë 10-mujori i vitit të kaluar me 10-mujorin e këtij viti. Kjo na vë në një bazë të barabartë.

Moza, çfarë ka për qeshur, apo se ministrja e mban peshën në kurriz gjatë administrimit të vitit.

Anila Denaj – Është një peshë që mban çdo ministër, si një përgjegjësi institucionale...

Arben Ahmetaj – Këtë ua them punonjësve të administratës, në respektin tuaj...

Anila Denaj – Besoj se nuk është punuar pak për miradministrim. Sigurisht që ka shumë për të bërë akoma, edhe vitin tjetër në tre dimensione, dhe besoj se do të sjellë një dinamizëm tjetër, kjo e ndërlidhur edhe me atë që thamë dje në raport me paketën fiskale. Kjo nuk është një paketë e mirëfilltë fiskale, por është një paketë, e cila jo vetëm për ligjin e fiskalizimit, që nuk është i vetmi instrument për të arritur miradministrimin, sjell të dhëna të shtuara në kohë reale. Por administrata në mënyrën sesi punon, sesi organizohet në strukturë dhe

se si ka efektivitet, duhet të sjellë më shumë. Këtë fokus e kemi treguar këtë vit, ku jam angazhuar personalisht, por edhe për vitin tjetër.

Në raport me të ardhurat, janë disa pyetje që kanë të bëjnë me efektin e situatës energjetike dhe të politikave të KESH-it, për prodhimin ose importin e energjisë. Për këtë mund të flasë zoti Lera.

Arben Ahmetaj – Niko, përpara se të kalojmë te kjo pyetje, bëra një pyetje për TVSH-në bruto dhe do të doja një përgjigje.

Niko Lera – TVSH-ja bruto në vitin 2019 nuk është realizuar në parametrat e projektuar, nuk ka ...

Arben Ahmetaj – Më fal, por po kërkoj vetëm shifrat, nuk ka nevojë për komente.

Niko Lera – Zoti kryetar, a mund ta japim pak më vonë përgjigjen e kësaj pyetjeje, sepse na duhet të bëjmë disa llogaritje?

Arben Ahmetaj – Patjetër.

Niko Lera – TVSH-ja e brendshme është arsyeja e rënies me 4,1 miliardë lekë ose 12 % të të ardhurave në raport me faktikun e vitit të kaluar. Faktorët që TVSH-ja e brendshme paraqitet me performancën jo të programuar janë:

Së pari, ndërprerja e arketimeve të këtij tatimi nga nënkontraktorët e projektit TAP. Ne ndryshuam skemën e projektit TAP, pasi kërkesat për rimbursim po pengonin aktivitetin ekonomik të kësaj kompanie dhe shteti e kishte të pamundur të rimbursonte të gjithë shumën menjëherë. Efekti në uljen e të ardhurave të brendshme nga ky faktor është 3 miliardë lekë në vit. Pra, nëse në vitet 2016, 2017 dhe 2018 janë arkëtuar mesatarisht 3 miliardë lekë në vit, nga nënkontraktorët e projektit, në vitin 2019 janë arkëtuar afërsisht 32 milionë lekë. Por dua të theksoj se këto 3 miliardë lekë të munguara në të ardhurat e buxhetit në formën e TVSH-së janë të shtuara 20-30% më pak kërkesa për rimbursim, të cilat do të jepen në një kohë të dytë për këtë tatimpagues. Po flasim për TVSH-në e brendshme.

Së dyti, prodhimi i energjisë elektrike nuk është në nivelin e vitit 2018, rrjedhimisht nuk ka pagesa për TVSH-në e brendshme nga KESH-i, por kjo TVSH është arkëtuar në import rreth 2,5 miliardë lekë më shumë, e krahasuar me vitin 2018. Për diferencën e dimë që kemi probleme të informalitetit dhe të nënraportimit, të cilat i kemi në analizë në mënyrë që t'i adresojmë, të gjejmë shkaqet dhe faktorët analitikë të tyre dhe në kuadër të projektit të fiskalizimit, i cili është projekti kryesor që do të influencojë dhe do të ndikojë në kontrollin e zinxhirit të faturimeve dhe

të TVSH-së, të marrim masat përkatëse për mbylljen e këtyre problemeve që lidhen me administrimin tatimor.

Për sa i përket pyetjes: sa është zhvlerësuar euro nga leku në vitin 2019, ne thamë se projeksionet për kursin e këmbimit i morëm me kursin e dhjetorit të vitit 2018, me rreth 126,5 lekë, llogaritëm bazën e importeve mbi këtë bazë dhe rezultoi me rreth 3 pikë pak lekë më e ulët, që ka dhënë atë ndikim që ministria përmendi në të ardhurat nga TVSH-ja e importeve.

Arben Ahmetaj – Zoti Niko, në normalitet vetëm në kalkulimin e borxhit merret kursi i këmbimit të datës 31 dhjetor. Pra vetëm për kalkulimin e borxhit, por për asnjë instrument tjetër, i kalohet mesatares dhe mesatarja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka problem, sepse e bëjmë edhe për t'u sqaruar me njëri-tjetrin. Mesatarja në vitin 2019, në kalkulimet tona rezultoi sot me 1,6% diferencë. Po t'i referohemi shtatorit të vitit 2018, ka qenë 123 lekë, pra në kursin e këmbimit mes euros dhe lekut. Ndërsa efekti mesatar i kursit të këmbimit në vitin 2018 ka qenë 6,2%. Pyetja ime apo e deputetit që e ka bërë, duhet ta keni me emër kush e ka bërë pyetjen...

Niko Lera – Zoti kryetar, është në setin e pyetjeve tuaja.

Arben Ahmetaj – Dakord, seti është i komisionit, por besoj se kanë ardhur me emra se kush i ka bërë pyetjet, por kjo nuk ka rëndësi. Po efekti makro në rritje të TVSH-së ku është, i nominales?

Niko Lera – Ne përmendëm faktorët negativë dhe pozitivë, rezultati final është miksi i të gjithë këtyre faktorëve. Natyrisht që ka edhe faktorë të panjohur nga ne, natyrisht që ka vend për adresim dhe analizë të thellë të problemeve të administrimit tatimor, por dua t'ju siguroj që llogaritjet për efektet e kursit të këmbimit për mallrat e importit bëhen 100% të sakta, sepse administrata doganore çdo muaj ka kursin mesatar të vitit paraardhës, por edhe kursin mesatar të muajit dhe vitit përkatës dhe në mënyrë automatike e nxjerr efektin. Prandaj efektet që ne raportojmë këtu janë 100% të sakta lidhur me kursin e këmbimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Endrit – Ajo që thatë ju për kursin nuk është e saktë, pra 6 pikë ca mbivlerësim në vitin 2018 dhe 1 pikë ca për qind në vitin 2019. E sakta është: euro është zhvlerësuar me 4,9 në vitin 2018 dhe me 3,5 në vitin 2019.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me 3,5. Kurset mesatare që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, do t'ju jap kurset dhe llogarinë e bëni me kalkulator. Kursi mesatar në vitin 2017 ka qenë 134,2 lekë, për euron, për vitin 2018 ka qenë 127,6 lekë dhe në vitin 2019 deri tani është 123,1 lekë.

Arben Ahmetaj – A mund të shkëmbejmë llogaritë ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na i dorëzo nëse mundeni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, një sekondë, zoti drejtor. Pra me një paragraf fare të shkurtër bëjini llogaritë dhe na i jepni që deputetët t'i referohen, vetëm kaq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo me telefon, bëje me nge gjatë ditës së sotme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – Zoti kryetar,...

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, më fal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të gjithë llogarinë që bëre me kursin mesatar, kujt i referohet, pika më e ulët dhe pika më e lartë, e ponderuar dhe jo e ponderuar, e kanë nxjerrë ose jo Banka e Shqipërisë. Endrit, logjika e përlllogaritjes ngaqë iu referove është e saktë dhe nuk është e saktë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë se po flas unë, mos u shqetëso, sepse llogaritë i kemi në shërbim të njëri-tjetrit, gjatë ditës, deri nga ora 5 ose 6, e bën dhe na e dorëzon, nuk është nevoja zyrtarisht, vetëm që ne t'i referohemi si deputetë dhe i saktësojmë pastaj, sepse më shumë na duhen për vitin tjetër se sa për atë që ka kaluar.

Po, zonja ministre.

Anila Denaj – Zoti kryetar, unë dua të theksoj që përgjigjet do të vijin të gjitha me shkrim për të gjithë kolegët, ashtu edhe për pyetjet shitesë që keni, sepse nga dje deri sot ne i kemi përgatitur, por nevoja për detaje është e nevojshme, por dhe koha është e nevojshme për t'u marrë.

Arben Ahmetaj – Ministre, pa merak fare, jemi në pritje dhe merrni kohën tuaj.

Anila Denaj – Besoj se shifrat janë këtu për t'u argumentuar nga të gjithë. Në gjykimin e ndarjes së përgjigjeve përtej kontekstit të të ardhurave dhe efekteve që thashë më lart, pozitive

ose negative, zoti Lera do të vazhdojë me të gjitha elementet për energjinë dhe për pyetjet e tjera që kanë të bëjnë me akcizën. Më pas do të kalojmë tek efektet që do të diskutojmë në raport me të ardhurat për vitin tjetër. Prandaj zoti Lera të vazhdojë për të gjitha detajet edhe me pyetjet shitesë.

Niko Lera – Unë po i kaloj pyetjet që kanë të bëjnë me kursin e këmbimit, sepse thamë që do të saktësojmë efektet e kursit të vitit 2018 dhe të vitit 2019.

Pyetja 10, për vitin 2019 të ardhurat nga kontributet parashikohen 94, 9 miliardë lekë me një rritje 1,7 miliardë lekë ose 1,8% e krahasuar me vitin 2018, nëse zhvishet nga efekti i rritjes së pagës minimale, sa është rritja e të ardhurave minimale nga kontributet në vitin 2019 e krahasuar me vitin 2018? Unë e kam dhënë përgjigjen bazuar në të ardhurat totale nga kontributet, sepse, përveç kontributeve që mblidhen nga administrata tatimore, që përbëjnë pjesën dërmuese të tyre, janë edhe kontributet që mblidhen nga Instituti i Sigurimeve për bujkun...

Arben Ahmetaj – Vetëm për fermerët.

Niko Lera – Po për fermerin. Po çfarë rezulton?

Arben Ahmetaj – Është një pjesë shumë e vogël e ...

Niko Lera – Po, 3,3 miliardë lekë. Përgjigja është: në vitin 2019 nga administrata tatimore dhe administrata e institutit pritet të arkëtohen 98 miliardë lekë, nga 97, 7 miliardë lekë të planifikuara. Ky është një vlerësim pothuajse 100% i sigurt. Pra, efekti nga rritja e pagës minimale në fillim të vitit, më 1 janar, ku efektin për bizneset e vogla e dhanë 20 prill, pra nga 24 mijë lekë në 26 mijë lekë, do të jetë 1 deri në 1,2 miliardë lekë, ndërsa pjesa tjetër vjen nga rritja e numrit të të punësuarve dhe nga rritja e nivelit të pagës mesatare. Në vitin 2018 ne arkëtuam 92 miliardë lekë, pra rritja 19, 18 me efektin e rritjes së pagës është plus 6,5% , ndërsa pa efektin e rritjes së pagës është plus 5,2%, pra nga efekti i miradministrimit, i luftës ndaj informalitetit e të tjera.

Pyetja 11: Si rezulton rritja e pritshme prej 1,7 miliardë lekësh e të ardhurave nga kontributet për vitin 2019 krahasuar me rritjen faktike të vitit 2018?

Rritja e vitit 2018, krahasuar me vitin 2017, ka qenë plus 7,3%, rritja e vitit 2019 krahasuar me vitin 2018 është plus 6,6%. Pra, kemi një rënie të ritmit të rritjes, por kjo është një rënie që verifikohet në pesë vjetët e fundit, sepse ne kishim shkallë më të lartë informaliteti para vitit 2013 apo edhe 2014. Ju besoj se jeni në dijeni që ne kishim vetëm 450 mijë të punësuar në listëpagesat e dorëzuara në institut, sot kemi 700 mijë të punësuar.

Arben Ahmetaj – Kjo është e vërtetë dhe do të doja që ju ta ritheksonit edhe për mediet që në aspektin e përgjithshëm të punës së mirë që bën ministria juaj, elementi i rritjes së punësimit dhe rakordimit të të punësuarve dhe rritja e kontributeve dhe përmirësimi i raportit pensionist me kontribuues, pra përfitues me kontribuues, dua që qytetarët dhe të gjithë ata që janë të interesuar ta dëgjojnë, duke përfshirë edhe këtë vit, është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme. Kjo tregon që zhvillimi ekonomik ka shkuar të qytetari. Do t'i lutesha edhe ministres, për shkak edhe të mesazhit politik, të përmendej krahasimi që ditën që kjo maxhorancë ka ardhur në pushtet kanë qenë mbi 423 mijë të punësuar, sot janë 720 mijë të punësuar. Edhe sikur “të shkartisim” ata që janë të dypunësuar, shkon në 690 mijë.

Pra, i gjithë diskutimi që bëhet për punësimin, rritjen ekonomike, vendet e punës, premtimi që ka bërë Kryeministri për 330 vende të reja pune janë aty, është dyfishuar punësimi, është rritur paga reale dhe paga mesatare, do të thotë se mesazhin politik kjo maxhorancë e ka orientuar drejt rritjes ekonomike të qytetarit. Duhet të theksojmë këtu që 96% e të punësuarve iu kemi ulur taksat dhe çdo vit rritet e ardhura për frymë. Ky është një nga momentet, zonja Ministre, ta ritheksojmë. T'i kthehem disa herë, madje unë dua ta ndaj me shqiptarët që ky diskutimi ynë teknik të ketë edhe një reflektim politik jashtë kësaj sale për punën e mirë që keni bërë dhe që ka bërë qeveria për transferimin e rritjes ekonomike te qytetarët. .

Zoti Lera, ju lutem, ritheksojini, sepse këto janë shumë të rëndësishme.

Anila Denaj - Ne e kemi përmendur në shumë dalje publike, gjithashtu, unë personalisht, si përfaqësuese e ministrisë, që efekti i rritjes së punësimit në të gjithë Ballkanin është më i larti në të gjithë rajonin, si rezultat i të gjitha masave që përmenda më lart, ne edhe në një referencë të fundit të një raporti të Bankës Botërore nga 62 mijë vende të reja pune, 30 mijë i takonin vetëm Shqipërisë, kështu që sigurisht ky është një proces i të gjithë informacionit me publikun.

Efektet nuk janë vetëm në kontekstin e numrit, por janë edhe në konceptin e vlerës, pasi është e njohur përpjekja për të ulur efektin e taksimit dhe sigurisht për të krijuar këtë burim të konsumi familjar, të mos harrojmë të gjitha shërbimet falas që shtohen, sidomos në raport me shëndetësinë.

Një nga pyetjet kishte të bënte me buxhetet me raportet specifike ndaj produktit të brendshëm bruto të arsimit dhe shëndetësisë, ku një pjesë e mirë e këtyre shpenzimeve, përveç përqindjes në vlerë absolute, shkon për shumë shërbime për qytetarët, që të krijojnë një bazë mirëqenieje ekonomike, edhe pse jo e argumentuar drejtpërdrejt tek të ardhurat mujore.

Arben Ahmetaj – Në periudhën kur maxhoranca ka drejtuar vendin, praktikisht Shqipëria renditet statistikisht si vendi me papunësinë më të ulët, 12,7% në rajon. Kjo tregon se ne kemi arritur maksimumin, por besoj se krahasimisht me atë që e morëm kur ishte 18,7% papunësia dhe me këtë që kemi sjellë sot, sigurisht që krahasimi vlen, nuk vlen në krahasim me pritshmëritë që kemi ne si maxhorancë, por vlen për ta ndarë me qytetarët përpjekjen e suksesshme, ende në mes të rrugës sonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, ju lutem, mos ndërhyjni në procedurë! Të jemi korrekt me njëri-tjetrin! Patjetër, po kur të të vijë radha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministre, nëse mundesh, nëse sekretaria jua ka sjellë me emra pyetjet, do t'ju lutesha që kur janë pyetje nga opozita, t'ju referoheni me emër.

Anila Denaj- Deri tani jemi duke iu referuar pyetjeve tuaja, zoti kryetar, më vonë do të ndjekim këtë procedurë. Viojmë me akcizën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Lera - Pyetje tjetër: Si rezulton plani i të ardhurave për vitin 2020 në raport me planin e parashikuar në PBA?

Përgjigjja: Nga axhustimet që kemi bërë, bazuar në faktorët që do të ndikojnë dhe që janë të identifikuar, kemi një reduktim prej 3\$.

Sa është parashikuar efekti i kuadrit makro në rritje e të ardhurave në vitin 2020?

Është kalkuluar nga rritja ekonomike që të gjenerohen 10,1 miliardë lekë dhe nga efekti i deflatorit 6,6 miliardë lekë, pra gjithsej 16,6 miliardë lekë.

Ju e dini që tashmë ne kemi një model të konsoliduar të parashikimit të të ardhurave që bazohet në modelet më të mira, të cilat i kemi marrë nga FMN-ja, ose Hawardi, të cilët marrin në konsideratë parashikimet makroekonomike, modelin bazuar në analizën e 60 grup produkteve, modelin bazuar në seritë kohore, dhe të gjitha teknikat bashkëkohore të programimit tatimor.

Arben Ahmetaj – Është i shpjeguar qartë në detaje dhe në relacion dhe është një metodologji e konsoliduar të paktën në 5 vjet.

Niko Lera - Sa është efekti i parashikuar në rritjen e të ardhurave, që vjen nga rritja e çmimeve në bursë, të cilat ndikojnë të ardhurat nga TVSH dhe nga renta?

Jemi treguar më të kujdesshëm për të mos përsëritur opsionet optimiste që parashikuam në vitin 2018, pra nga plus 28% që parashikuam rritjen e çmimit të naftës, jo se e shpikëm ne,

por iu referuam parashikimeve të institucioneve të specializuara ndërkombëtare, sivjet kemi parashikuar një rritje deri në 10%. Megjithatë detajimi i taksave në strukturë nga totali i të ardhurave që kemi parashikuar në vitin 2020 do të jetë subjekt i një pune të vazhdueshme që ne do të bëjmë deri në fund të vitit që të precizojmë secilën taksë të projektuar për vitin 2020.

Të ardhurat nga akciza programohen 55, 5 miliardë lekë me rritje plus 2,8 miliardë ose plus 5,9% më shumë se pritshmëria e vitit 2019.

Sa është efekti i rritjes së parashikuar nga akciza e cigareve?

Ju e dini që ne kemi një skedulinë në ligj për rritjen e akcizës së cigareve dhe efekti në vitin 2020 do të jetë 750 milionë lekë. Pra, nga 2,8 miliardë të programuara 750 milionë lekë do të gjenerohen nga rritja e akcizës dhe diferenca 2,05 miliardë do të gjenerohet nga efekte të tjera që kanë të bëjnë me rritjen ekonomike.

Si rezulton rritja e programuar e të ardhurave nga akciza e zhveshur nga efekti që vjen nga rritja e taksës krahasuar me rritjen mesatare të të ardhurave nga kjo taksë për periudhën 2016-2018?

Në periudhën 2017-2018 kemi ulje të të ardhurave nga akciza me 0,3 %, në vitet 2019-2018 kemi rritje 6,2% dhe në vitet 2020 – 2019 kemi rritje 4,8%. Pra, akciza në përgjithësi po ta shënojmë dhe në një seri 1-vjeçare nuk ka pasur një trend të qëndrueshëm në kuptimin që çdo vit të rritet 5-6%, por ka pasur luhatjet e saj.

Arben Ahmetaj – Zoti Niko, kam kërkuar të dhënat e mallrave të akcizës për të parë në tabelë ecurinë e mallrave të akcizës për karburantin, cigaret, kafënë, pijet alkolike. A mund ta kemi atë tabelë?

Niko Lera – Patjetër që mund t’ju vëmë në dispozicion të gjitha mallrat në sasi dhe vlerë të importuar në vite.

Arben Ahmetaj – I duam në sasi për të gjykuar për konsolidimin e bazës së akcizueshme. Kur mund t’i marrim?

Niko - Nesër në mëngjes mund t’jua sjellim.

Arben Ahmetaj– A nuk mund të na i sillni brenda ditës së sotme?

Niko Lera - Po nëse do të rrimë gjithë ditën këtu...

Në seancën e orës 17:00 mund t’jua vëmë në dispozicion.

Anila Denaj – Në lidhje edhe me pyetjen për çështjen e programimit të të ardhurave për individë për frymë dhe në vijim të asaj që folëm dje në raport me impaktin që do të sillte ky buxhet për rritjen e punësimit për vitin e ardhshëm ne përmendëm dje një mundësi për 30 mijë

vende të reja pune, ndërkohë vetëm efekti për të ardhurat e disponueshme për çdo banorë do të rritej me 240 euro për çdo banorë dhe, nëse do të aplikonim paritetin e fuqisë blerëse, do të rritej me 600 euro për banorë. Është e nevojshme ta themi këtë.

Arben Ahmetaj- Duhet ta përsërisni këtë gjë, sepse është rëndësishme.

Anila Denaj - Po duhet ta themi këtë gjë, është e nevojshme ta themi, unë do të mbetesha jo për vlerën më të lartë të 600 euroshit te pariteti, por është një indikator ndërkombëtar që pariteti vendos në një shkallë barazimi të gjitha vendet e ndryshme, të cilat krahasohen dhe 600 euroshi do të ishte vlera që do të duhej të përmendej në këtë indikator.

Arben Ahmetaj – Ministre, besoj se punonjësit tuaj do ta konfirmojnë që rritja që nga viti 2013 e prodhimit të brendshëm bruto për banorë në mijë/lekë për periudhën 2013-2019 është 27,2%. Pra, është një shifër që në zhargonin gazetaresk neglizhohet në vazhdimësi. Këtë fakt dua ta ndaj me gazetarët dhe deputetët, që rritja e prodhimit të brendshëm bruto për frymë në mijë/lekë ka një rritje 27,2%. Sigurisht, çdokush prej nesh mund t'i referohet konvergjencës, e cila do të duhej të ishte shumë më e shpejtë për t'u përputhur një ditë me mesataren e Bashkimit Europian, gjë që është ambicie shumë e guximshme dhe kërkon një rritje ekonomike të paktën 4,5-5% për të përgjysmuar vitet. Pra, kjo është një shifër shumë e rëndësishme, të cilën do ta ndaj edhe me gazetarët. Nëse në vitin 2013 ka qenë 466,3 mijë/lekë...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, është një pyetje e zonjës Dhima. Kur të vijmë te pyetja juaj mund t'i referoheni.

...në vitin 2013 në vitin 2019 është 593,4 mijë/lekë. Këto janë tabela të Fondit Monetar të rakorduara edhe me INSTAT-in. Pra, kemi një rritje të konsiderueshme për qytetarët prej 27,2, tamam është 27,24%.

Faleminderit!

Fjala për zonjën Ministre.

Anila Denaj – Më lejoni t'ju them që edhe në PBA kjo rritje në përqindje euro/banorë, e cila vjen nga 0,9% në 2013, në 3,2, 3,7, 5,2 respektivisht për vitet, 10 në 2018, vazhdon 85,...

(Diskutime pa mikrofon)

Rritja në përqindje parashikohet të jetë në nivelin 6% për 3 vjetët e ardhshëm. Kjo tendencë do të jetë e parashikuar në rritje.

Për të vijuar me të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat rriten me 4,8%. Pyetja është se cila është norma mesatare e rritjes së të ardhurave nga kontributet në periudhën 2016-2018. Krahasimisht çdo vit me tjetrin, si 2015-2016 e kështu me

radhë, flasin për një rritje me 11,2%, 10,4%, 7,3%, 6,6%, si dhe duke parashikuar periudhën 2019-2020 me 5,6%. Shkalla e informalitetit sigurisht vjen në reduktim dhe në këtë aspekt është e nevojshme të themi që kontributi që është dhënë për të rritur nivelin e punësimit, por njëkohësisht edhe uljen e informalitetit ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë tregues.

Arben Ahmetaj – A mund t’ju bëj një pyetje shtesë? Po i referohem rritjes, në fakt, të sigurimeve shoqërore, që është 5%. A nuk do të duhej të ishte në harmoni me rritjen totale të taksave? Edhe pse përllogaritja shkon në numër punonjësish në pagë mesatare edhe me decimile të ndryshme, është e njëjta logjikë. Mos ndoshta duhej të rriteshin edhe sigurimet shoqërore me 6,2% sa ç’rritet edhe totali i të ardhurave nga tatimet dhe doganat?

Anila Denaj – Parashikimi për periudhën 2019-2020 është 5,6% . Sigurisht, besoj se këtu si faktor ndikon edhe pjesa e informalitetit, por edhe gjithë përpjekja për ta ulur këtë informalitet gri në punësim.

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, për korrektesë të shifrës, të cilën këtu e kemi, 4,6% është rritja nga viti në vit. Pra, për periudhën 2019-2020, në buxhetin e vitit 2020 rritja është 4,6%, ndërkohë po t’i referohemi çdo viti tjetër, po marr vitet 2016, 2017, 2018, për të krijuar një dysheme pak më shëndetshme dhe një argumentim më të thellë teknik, viti 2020 është 4,6%, viti 2019 është 6,7%, viti 2018 është 7,3%, viti 2017 është 11%, viti 2016 është 10,9%. Pyetja që unë kam, e cila është mëse logjike dhe normale, pse për vitin 2020 duhet të pranojmë një ritëm më të ulët sesa, po i referohem mesatares, mesatarja e 4 vjetëve? Cila është arsyeja që ju mendoni që rritja do të jetë vetëm 4,6% dhe jo 6,7%, po marr pikën më të ulët gjatë këtyre 4 vjetëve, që është ajo e vitit 2019?

Në anën tonë do të këmbëngulim që të jetë e njëjta logjikë me vitin 2019 që ka qenë 6,7% dhe po aq të jetë edhe 2020. Ndërkohë, ne planifikojmë, siç e thatë edhe ju, rritje punësimi, rritje ekonomike, rritje të pagës mesatare, e cila automatikisht na çon në më shumë sigurime.

Anila Denaj – Kjo është një çështje që duhet të trajtohet pak më gjerë edhe në raport me elementin në zonat rurale. Po të vijoja diskutimin me ato që thashë pak më parë për të ardhurat e reduktuara që vijnë nga zonat rurale, mendoj që ka shumë hapësirë për ta parë këtë aspekt, për të krijuar një bazë më të shëndetshme në raport me kontributet për këtë pjesë të popullsisë, e cila nuk është pak, por 42% e alokuar në zonat rurale.

Sigurisht, shkalla e informalitet vjen në reduktim, baza vjen e ndryshueshme dhe kjo jep efekt edhe në përqindje. Në të ardhmen kjo do të jetë brenda parametrave, siç jua thashë pak më

parë, 5,6% për vitin që vjen dhe besoj që me një bazë më të lartë edhe përqindja do të vijë duke u ulur në vijim.

Një nga pyetjet lidhet me faktin nëse do të ketë masa që sjellin të ardhura *one off* për vitin e ardhshëm. Në fakt, kemi diskutuar brenda ministrisë për situata, të cilat mund të mendohet që sigurojnë një të ardhur shtesë *one off*, siç ishte ajo e vitit të kaluar, e cila është përmendur nga ju, zoti kryetar, për pjesën e dividendit dhe mendojmë se mund të jetë e nevojshme parja e një elementi të tillë, por nuk e kemi sjellë në qasje në këtë masë, por mund ta mendojmë...

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, a mund të biem dakord për ta shpallur?

Anila Denaj – Po.

Arben Ahmetaj – Pra, ju jeni duke bërë një vlerësim me Kryeministrin dhe unë në diskutim me ju kam marrë përsipër të bëj një propozim për amendament, pasi ju të keni rënë dakord si qeveri, duke parë edhe të gjithë elementet që kanë të bëjnë me MANIVAL-in apo me vlerësimet e tjera sa i përket një rivlerësimi të mundshëm. Pra, jam duke iu referuar një rivlerësimi të mundshëm, të cilin do të isha gati ta bëja si amendament kur komisioni dhe ju si përfaqësues të qeverisë të biem dakord, pasi ju të keni bërë vlerësimet në lidhje me ato që thamë më lart. Është momenti që ta informojmë edhe publikun që unë, si kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe ju si ministre e Financave jemi duke diskutuar këtë alternativë, pasi ju të keni bërë vlerësimet tuaja me institucionet që ju keni në varësi dhe me Kryeministrin.

Anila Denaj – Zoti kryetar, këtë do t'jua sjellim brenda ditës së sotme, pasi jemi duke analizuar edhe elementet që lidhen me MANIVAL-in. Më lejoni t'ju them se kjo është një nismë, e cila ka ezauruar dy herë një numër të konsiderueshëm pasurish, respektivisht kur është aplikuar me 1%, 90 mijë herën e parë, 60 mijë herën e dytë dhe ne parashikojmë që nëse aplikojmë një ritëm, të cilin nuk e kemi ende të shpallur, por nëse vendosim një efekt të tretë mendojmë që të paktën 30 deri në 40 mijë pasuri mund të rivlerësohen për një efekt 9-mujor, deri në shtator, jo deri në fund të vitit.

Nëse do t'i përgjigjem pyetjes se çfarë efekti do të ketë, mendoj që për vitin që vjen *one off* efekt do të ishte te 4 miliardë lekë net. Megjithatë, siç jua thashë, propozimin do t'jua sjellim sot së bashku me raportin MANIVAL dhe informacionin, sepse është e rëndësishme që ata të jenë pjesë e këtij komunikimi...

(Diskutime pa mikrofon)

Një element shumë i rëndësishëm, edhe nga këndvështrimi që kanë sjellë pyetjet e zotit Angjeli, ka qenë administrimi fiskal dhe efekti që do të ketë në buxhetin e 2020-ës miradministrimi fiskal. Faktikisht janë dy elemente që mendojnë për miradministrimin fiskal me një efekt prej 6,2 miliardë lekësh për vitin tjetër, i cili parashikohet në dy elemente. Nuk mendoj se efekti i fiskalizimit do të japë menjëherë efekt vitin që vjen, por mendojmë që ky efekt në vlerë monetare do të jetë te 2 miliardë lekë, duke presupozuar se do të rritet me atë efekt që kemi përmendur në fillim kur kemi lancuar projektin të paktën 9,2 deri në 9,5% të PPP-së si efekt që vjen nga fiskalizimi.

Për vitin që vjen ky efekt do të jetë 2 miliardë lekë, duke menduar që një proces kaq i rëndësishëm kërkon kohë për bizneset që të adoptohen dhe kjo, besoj se sot do të jetë duke ardhur te ju, por një kohë prej 6 muajsh e kemi anonçuar se do ta marrim si fazë tranzitore. Kjo ngelet për t'u diskutuar në komision, por ky është propozimi ynë si qeveri.

Nga ana tjetër mendoj se ka shumë elemente që mund t'i rrisim në efektivitet në raport me strukturat dhe me përpjekjet për t'i lehtësuar më mirë të dhënat, të cilat do të kërkojnë koordinimin ndërinstitutional, i cili këtë vit ka rezultuar shumë pozitiv dhe besoj se do të vijojë edhe në vijim, sigurisht i kryesuar jo vetëm nga ministri i Financave, zëvendëskryeministri, por edhe nga vetë Kryeministri me mesazhin për të luftuar evazionin fiskal dhe informalitetin.

Eurobondi, sigurisht, është një produkt shumë i rëndësishëm për Ministrinë e Financave për vitin që vjen. Përtej afatit kohor të maturimit të tij në nëntor për arsye të zhvillimit të të gjitha tregjeve ndërkombëtare financiare kemi nisur ndërkohë punën për të punuar për Eurobondin, për të përzgjedhur në fazën e parë kompaninë konsulente juridike. Mendojmë që ky proces mund të na çojë në muajin maj në dalje për të parë mundësinë e tregut dhe duke shpresuar që 6-mujori i parë i vitit tjetër të jetë një 6-mujor më i lehtë për t'u parashikuar, ku investitorët në këtë rajon, siç ishte blerja më e fundit në Serbi apo në Mal të Zi kanë ende **Yield**-e dhe besoj që do kjo të jetë diçka pozitive.

(Diskutime pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Shiko, ti që nuk e dije e mora vesh tani. Tri pyetjet që unë kam bërë më duken shumë korrekte...

(Diskutime pa mikrofon)

Merre fjalën. Kush të ndaloj? Ti nuk e ke me mua, e ke me kryetarin.

Arben Ahmetaj – Zoti Angjeli, më falni!

(Diskutime pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Unë ndjek procedurën e zhvillimit të mbledhjes në komision.

(Diskutime pa mikrofon)

Ministrja foli dhe përmendi me emër pyetjet e mia, mbaroi përgjigjen dhe unë si i edukuar që jam dua ta falënderoj për përgjigjet që më dha.

Ju keni kundërshtim për falënderimin?

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, kam një merak për ta ndarë...

Zoti Roshi, ju lutem, kur të përmenden pyetjet tuaja, do ta merrni fjalën menjëherë!

(Diskutime pa mikrofon)

Ministrja iu referua pyetjeve me emër.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju kërkoj ndjesë.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk ka gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur të doni mund të flisni. Ne e vlerësojmë prezencën dhe kontributin tuaj në komision.

Zonja Ministre, kam një shqetësim. Ripagesat për vitin 2020 më rezultojnë rreth 83 miliardë, që do të thotë se me një kalkulim të thjeshtë Republika e Shqipërisë do të shkojë për të kërkuar afërsisht 62-65 miliardë lekë, Endrit, më korrekto për shifrat, sepse dua të jem korrekt. Pra, pagesat janë 83 miliardë, e brendshmja shkon diku te 21-22,9%, që do të thotë se ju do të shkoni në tregun ndërkombëtar afërsisht për 61,7. Ndërkohë, prapë më korrigjo për shifrat, keni planifikuar në interesa 40,9 miliardë, që është vetëm 950 milionë lekë plus nga viti 2019. Jam korrekt me shifrat? Dakord. Meraku im është: a mendoni se nuk do të ngacmohen interesat? Këtë nuk e kam pyetje për përgjigje, por e kam merak. Gjithsesi, ne e kemi baferin prej 4 miliardësh, nuk diskutohet, por thjesht e hodha merakun që ju ta keni parasysh kur ta planifikoni për vitin tjetër. Edhe në traditën tonë, kur ka qenë zoti Cani përpara, apo kur baf u vendos në vitin 2016 zyrtarisht, ne e kemi përdorur baferin edhe për mosrealizimet, të cilin do ta përdorim, por arsyeja pse unë ju kaloj shqetësimin juve është që të mos i kemi të dyja, edhe ngacmimin e interesave, edhe ndonjë mosrealizim të mundshëm, që vjen për shkak të rritjes, për shkak të çmimeve e të tjerë. Pra, thjesht po ju kaloj merakun në parim.

Anila Denaj- Është një merak që edhe ne e ndajmë dhe një nga arsyet pse koha për të shkuar më shpejt në eurobond është sepse 6-mujori i parë mund të parashikojë një efekt më mirë

sesa ai i dyti, sikurse edhe eksperiencia që ka pasur rajoni në muajt e fundit. Rezerva është edhe me merakun që ju shprehët, por ne jemi optimistë që edhe kohën e kapim, edhe efektin e interesit besoj se do ta amortizojmë. Megjithatë, merakun është i shënuar dhe është i ndarë.

Në qoftë se më lejoni, po kaloj nga pyetjet e opozitës, që të mos kemi...

Arben Ahmetaj- Zoti Roshi, keni të drejtën dhe lejen të ndërhyni sa herë të doni tani që janë pyetjet tuaja, por pa i ndërprerë fjalën ministres.

Anila Denaj – Edhe dje ne kthyem përgjigje për disa pyetje.

Për vlerën për frymë për banorë, unë i dhashë përgjigjet pak më parë, por më lejoni që të përsëris të njëjtën përgjigje që thashë pak më parë, sepse treguesit janë shumë qartë të paraqitur në tabelën e fiskut. Në euro vlefa për banorë është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe unë atë po bëj. Përgjigjen e pyetjes së parë e kam dhënë, por u bë një gabim, sepse praktikisht ishte përgjigjja e pyetjes suaj. Elementi i rritjes për familje për banorë, unë e thashë pak më parë, në raport me fuqinë blerëse është në 600 euro.

Ndërkohë, pyetjes sesi e mendojmë ne në këtë projektbuxhet të joshim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në vit, për banorë. Kjo me indeksin e PPP-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këta janë treguesit. Ata janë vjetorë dhe në vlerë absolute është nga 11614 euro në 2018 në 12720, ku parashikohet që në tre vjetët e ardhshëm të shkojë 13464, 14866 dhe 15247 euro për frymë në vit.

Pyetja tjetër. Si parashikoni ju në këtë projektbuxhet të joshni duke tërhequr vëmendjen e të rinjve që të ardhmen e tyre ta shohin në vendin tonë?

Unë do t'ju jap përgjigje që nuk ka tregues në fisk, por ka një tregues shumë kokëfortë në raport me të rinjtë. Të rinjtë sot, nëpërmjet politikave të qeverisë shqiptare, janë adresuar me arsimin, si me atë të lartë universitar, që këtë vit, viti korrent që flasim, dhe vitet në vijim kanë marrë pjesën më të lartë të buxhetit, por edhe arsimin profesional. Më lejoni t'ju them që Shqipëria, përveç atraksionit ndaj investitorëve të huaj, duhet sigurisht të rritë dimensionin e arsimit profesional shumë më tepër se sa ka qenë në vitet e mëparshme. Të gjithë investitorët e huaj kërkojnë një fuqi punëtore, e cila është e trajnuar dhe 57% e fuqisë sonë aktive punëtore është me moshë mesatare më pak se 31 vjeç. Ky është një element shumë i rëndësishëm i atraksionit për investitorët e huaj, përfshirë edhe automobilistët, të cilët i adresuam në paketë

fiskale, pasi në Shqipëri kemi kërkesa konkrete për ta dhe me projeksione për rritje të punësimit në 5 vjetët e ardhshëm me 5 mijë vende pune. Megjithatë, arsimi profesional është i rëndësishëm për t'u adresuar. Sot kemi 19400 nxënës të arsimit profesional dhe i gjithë dimension i investimit në shkollat profesionale, jo vetëm në infrastrukturë, i cili këtë vit ka qenë një nga investimet kryesore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por edhe në kurrikula, edhe me ndihmën e donatorëve, sidomos Swisscontact, SEKOS, GIZ-it e të tjerë kanë sjellë një qasje proaktive. Mendoj që një problemet që ne kemi në raport me këtë element është vetëm lëvizja demografike, sepse sot shumica e popullsisë, edhe e asaj që është fuqi punëtore, është e përqendruar në Tiranë dhe Durrës dhe, megjithëse ka biznese, në Berat sot e kanë shumë të vështirë të gjejnë fuqi punëtore për të punësuar. Zyrat tona të punës, për arsye të kësaj lëvizje demografike, nuk arrijnë dot të gjejnë në Berat mjaftueshëm punonjës për investitorët shqiptarë e të huaj, por treguesit, siç e thashë pak më parë, në raport me arsimin janë shumë të rëndësishëm për t'u përmendur.

Artur Roshi – Pyetja është: sa atraktiv është buxheti për të rinjtë, në mënyrë që të mos emigrojnë dhe të ndërtojnë jetën e tyre në vendin e tyre? Ju mendoni se arsimimi është ai që duhet t'u ofrojmë për t'i tërhequr, por nuk mendoni se ka shkaqe të tjera ekonomike, përveç arsimimit. Sigurisht që arsimimin e vlerësoj, sepse nëpërmjet arsimimit ne mund të zhvendosim mjerimin, ka thënë Mithat Frashëri, por problemi është tek të ardhurat ekonomike që u garanton buxheti, për shembull, pagat dhe jetesa e tyre për të mos emigruar.

Anila Denaj- Sigurisht që nuk është vetëm arsimimi, por unë përmenda vetëm vëmendjen që ka marrë arsimimi këtë vit dhe në vitet në vijim, por në 5 vjetët e shkuara buxheti, dhe jo vetëm, por e gjithë politika fiskale, ka shkuar drejt insentivit për të hapur vende të reja pune dhe me rezultate, që unë i përmenda dhe nuk kam pse t'i përmend përsëri. Vendet e punës janë ato që do të bëjnë të rinjtë të rrinë në Shqipëri, por këto vende kërkojnë edhe arsimimin dhe, sigurisht, arsimimi nuk përmendet, nuk duket në buxhet dhe në shifra, por është aty në vlefta, në shkolla dhe në investime publike, të cilat jo vetëm arsimi i lartë, siç do të shikojmë pastaj për çdo zë buxheti për investime, por dhe arsimi profesional nuk ka marrë pak vëmendje, duke e rritur nga 14 mijë numrin e nxënësve në 19 mijë në katër vjetët e fundit. Këto janë ato, të cilat kërkojnë nga investitorët e huaj, që vjet ishin 1 miliard euro dhe këtë vit, në 6 mujin e parë, janë 10 % më shumë se gjashtë muji i parë i vitit tjetër. Këto janë shifrat, se po të kalojmë te punësimi, ajo do ta mbajë, sikurse edhe shërbimet cilësore, një shërbim arsimit është një element,

shëndetësia është elementi i dytë më i rëndësishëm, siguria e të tjerë. Po flasim për arsim dhe shëndetësi, që janë elemente të rëndësishme edhe për të rinjtë në Shqipëri.

Arben Ahmetaj- Zoti Roshi, ndjesë! Ky nuk është debat. Ju mund t'i bëni pyetje për të sqaruar pyetjen tuaj, por jo debat, të lutem!

Artur Roshi - Zonja Ministre, ndjesë për ndërhyrjen e dytë për të njëjtën pyetje, por, pasi mbarojnë shkollën, ata largohen. Pra, pyetja ime këtu konsiston: Si e keni bërë buxhetin atraktiv që ata të mos largohen dhe sa efekt ka buxheti i këtij viti, që rinia të mos largohet pasi ka mbaruar shkollën? Me pjesën e parë jam dakord, që arsimimi vepron në mënyrë të tërthortë për t'u dhënë atyre mundësinë për t'u punësuar, por problemi vjen në fazën e dytë, pasi ata kanë marrë edukimin. Çfarë u ofron buxheti atyre për të qëndruar këtu, në politikat buxhetore ekonomike?

Anila Denaj- Po e përsëris. Punësimi....

Arben Ahmetaj- Zonja Ministre, mund të vazhdoni.

Mimoza Dhëmbi- Atëherë, po i marr pyetjet siç janë bërë. Pyetja ishte: në respekt të prindërve tanë, a do të ketë rritje të pensioneve këtë vit? Ju e keni fjalën për vitin 2020 dhe përgjigja është po. Në bazë të reformës së pensioneve, që u miratua në vitin 2015, është një detyrim i përvitshëm i buxhetit të indeksojë pensionet, pra jo t'i rritë, por t'i indeksojë me indeksin e çmimeve. Është një shportë specifike për pensionistët dhe çdo vit ne kemi detyrimin ligjor të parashikojmë fondin, 2 miliardë e 520 milionë janë parashikuar në buxhetin e vitit 2020 për këtë qëllim. Shpërblimi në fund të vitit nuk parashikohet që në buxhetin fillestar, por në përputhje me mundësitë e buxhetit dhe në përputhje me ecurinë e të ardhurave të vitit në tërësi gjenden mundësitë nga kursimet ose miradministrimi dhe bonusi i pensionistit realizohet në fund të vitit, ashtu siç po përpiqemi edhe këtë vit, që në fund të vitit të realizojmë pagesën e bonusit për 2019.

Arben Ahmetaj- Me leje, zoti Roshi, ka procedurë në komision, s'mund ta marrësh fjalën...

Artur Roshi-Ju më thatë më parë që mund të....

Arben Ahmetaj- Mund ta merrni sa herë të doni në bazë të procedurës, ju lutem!

Artur Roshi – Për ta sqaruar

Arben Ahmetaj -Do ta sqaroni drejtoreshën?

Artur Roshi – Ajo ktheu përgjigje.

Arben Ahmetaj- Besoj se drejtoresha ka nevojë për sqarim për 2,52 miliardëshin.

Artur Roshi –Pyetja ime ishte duke marrë shkas nga mosdhënia, në qoftë se nuk jepen, sepse ende ka kohë, për pensionistët për festat e fundvitit një shpërblim X i caktuar. Pra, nga kjo kam marrë spunto për të parashikuar që tani për vitin që vjen, nëse është e mundur. Kjo ka qenë logjika e pyetjes.

Arben Ahmetaj- Drejtoreshë, mos jepni përgjigje lidhur me këtë pyetje, sepse ju iu përgjigjët saktë pyetjes. Kjo, praktikisht, është në dorë të Kryeministrit dhe të ministres së Financave që në bazë të ecurisë së të ardhurave, të deficitit e të tjerë të marrin vendimin, të planifikojnë, të vijnë në Kuvend, në qoftë se ka nevojë për akt normativ, dhe të ecim. Pra, përgjigjja është e qartë.

Vazhdojmë me përgjigjet e tjera.

Faleminderit!

Mimoza Dhëmbi - Në lidhje me dëmshpërblimin e të përndjekurve politikë, është e vërtetë që kjo qeveri ka siguruar përshpejtimin e kësaj pagese në vite dhe aktualisht ne po përfundojmë dëmshpërblimin e plotë për ish-të përndjekurit që janë gjallë, pra të kategorisë parësore. Ndërkohë, vazhdon paralelisht pagesa e kështit të tretë për trashëgimtarët. Edhe kjo pagesë ose fondi për dëmshpërblimin e të përndjekurve lidhet me mundësitë e buxhetit, kuptohet që është i skeduar në kohë. Në vitin 2020 është parashikuar i njëjti fond, që ishte edhe në vitin 2019, por çdo mundësi të re që gjendet gjatë vitit kur ne bëjmë ndryshime të buxhetit, e shtojmë këtë fond, por, sidoqoftë, parashikimi fillestar bazik është parashikimi që kishim edhe në vitin 2019.

Arben Ahmetaj – Më falni, si ishte?!

Mimoza Dhëmbi – Ndoshta pjesa që ngeli pa përgjigje, është se sa vite do të duhet të dëmshpërblehen totalisht. Unë ju përgjigja që do të jetë në përputhje me mundësitë e buxhetit. Nëse hapësira e buxhetit na lejon ta përshpejtojmë, mund të avancohet, por një vlerësim bazik që është për 3 vjetët e ardhshme do të jetë aq sa është në vitin 2019, pra pa e rritur dhe pa e ulur.

Arben Ahmetaj – Zonja drejtoreshë, është shumë e rëndësishme t’ju a thoni qytetarëve që, në qoftë se do të bëhej ajo që mendohet, shkon deri në 600 apo 700 milionë euro me logjikë. Por të rrimë te 1 miliardëshi i çdo viti. Një ditë, kur të keni mundësi, dërgojani zotit Roshi, në respekt të pyetjes së tij, edhe si ka ecur që ta ketë si statistikë për veten e tij.

Faleminderit!

Ju lutem, mund të vazhdoni me përgjigjet!

Mimoza Dhembi – Sa do të jetë investimi për këtë vit në infrastrukturën rrugore? A prek ky investim aksin Kardhiq-Delvinë dhe në çmasë; po akset Orikum-Dukat, Milot–Balldren, Elbasan-Banjë e të tjera? Lista e investimeve është paraqitur, bashkëngjitur dokumentit të buxhetit 2020, por, duke i marrë pyetjet konkrete se kur do të përfundojë, për shembull, aksi Orikum-Dukat sapo është lidhur kontrata dhe nuk mund të flasim sot për përfundimin. Ka një kontratë që do të zgjasë disa vjet dhe është me PPP.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është në listën e pagesave të PPP-ve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Orikum-Dukat nuk ka pagesa të menjëhershme për vitin 2020, por i ka të skeduluara në 10 vjetët e ardhshme, sepse janë me PPP. Ne nuk ju dhamë përgjigje konkrete për çdo objekt, pasi ministria e Infrastrukturës do të jetë në komision dhe mund t’ju japë detaje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në vijim të propozimit që zoti kryetar bëri, ne po përpiqemi të bëjmë një listë më afatgjatë të investimeve për të parë konkretisht se kur përfundon çdo segment. Pra, do ta shtrijmë jo 3 vjet, por 10 vjet për të parë përafërsisht se kur mbaron secili segment që ka filluar dhe projektet e reja që sapo kanë filluar.

Artur Roshi – Zoti kryetar, pyetja është konkrete, e thjeshtë dhe e shkurtër: sa do të jetë investimi për infrastrukturën rrugore këtë vit? Konkretisht, a prek investimi në aksin Kardhiq–Delvinë dhe në çfarë mase? Pra, a ka intensitet? Është logjika e investimit për këtë vit dhe pak a shumë, të krijohet ideja se për sa vite mbaron. Po akset Orikum- Dukat, Milot-Balldren, Elbasan- Banjë? Pra, këto janë konkrete, ka, apo nuk ka investime? Në qoftë se nuk ka, ta kuptojmë që nuk ka.

Arben Ahmetaj - Me lejen tuaj dhe, në respektin tuaj, po jua jap unë përgjigjen. Transporti i brendshëm rrugor është 4,7 miliardë; Moza, më korrigjoni me shifrat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është 4,7 miliardë, i gjithë transporti rrugor i brendshëm dhe i huaj shkon diku te 14,7 miliardë. Milot-Balldreni nuk financohet vitin tjetër, Orikumi financohet me 300 milionë. A është kështu, Moza? Banja financohet me 52 milionë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është pagesa e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke bajpasin e Tepelenës 300 milionë. Ju lutem, Moza, më korrigjoni! *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, 300 milionë është fiks.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Roshi, ashtu siç tha drejtoresha, ne dje diskutuam me ministren për atë që quhet si koncept në buxhet *autcrowding*. Domethënë, vonesat e ndryshme shtyjnë proceset fizike, për shkak të mundësisë së financimeve dhe drejtoresha sot ju tha se ne do t'ju sjellë një tabelë, e cila do të tregojë në detaje të gjitha ato që ju pyetët, në legjitimitetin tuaj.

Faleminderit!

Anila Denaj – Sigurisht, ne kemi zgjatur afatin, për të qenë korrektë dhe për të paguar në kohë. Megjithatë, më lejoni të them se bajpasi i Fierit përfundon në vitin 2021, por sot rruga është funksionale. Në këtë aspekt, sigurisht ka shkurtuar kohë dhe ka rritur mundësinë për më tepër turizëm. Bajpaset e Vlorës dhe Qukësit, bajpasi i Shkodrës dhe bajpasi i Tepelenës janë në proces dhe nuk përfundojnë brenda vitit që flasim, por nuk pengojnë rritjen e ekonomike, sepse qoftë edhe gjysma e aksit, që është funksional, krijon lehtësi shumë më të mira.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka nevojë të jetë e gjitha e mbaruar.

Arben Ahmetaj – Do të keni edhe ministren e Infrastrukturës këtu dhe mund t'ia bëni të njëjtën pyetje, nëse do të dëshironi.

Mimoza Dhemb - Pyetja e 9 ka të bëjë me investimet në energji prej 2,5 miliardë lekësh. Në fakt, janë projektet e financuara nga donatorë të huaj, janë vlerësuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po në infrastrukturën energjisë ku konsiston investimi prej 2,5 miliardë lekësh, në integrimin e rrjetit energjetik me atë europian apo ndonjë riparim të rrjetit të brendshëm? Unë po ju them se investimet në rrjetet e brendshëm, investimet e vogla, bëhen nga vetë kompanitë publike, që janë OSHEE-ja, OST-ja dhe KESH-i. Ato nuk reflektojnë në buxhet. Ato janë investime që mbulohen me të ardhurat e vetë kompanive. Investimi prej 2,5 miliardë lekësh, që ju shikoni në buxhet, është investim nga projektet e donatorëve të huaj, ku shteti është garant ose huadhënës. Pra, nuk tregon të gjitha investimet e sektorëve energjetikë.

Artur Roshi – Pyetja ime është: a ka politika të tilla projektbuxheti që ne ta përafrojmë integrimin e rrjetit tonë të infrastrukturës, energjetike me atë europiane? Në qoftë se ne kemi një investim të pjesshëm në një dëmtim, kjo nuk vlen për të ardhmen.

Arben Ahmetaj – Zoti Roshi, a pranoni një përgjigje nga ana ime për këtë, sepse pyetja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja juaj është korrekte. Sot Shqipëria, në aspektin e konjektivitetit energjetik, është e gjitha e lidhur me sistemet europiane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta dëgjojnë qytetarët, ne kemi disa linja interkonjeksioni ku kemi punuar dhe na kanë futur në sistemin europian.

Së pari, është Podgorica.

Së dyti, është Elbasani deri në Bitola, Maqedoni.

Së treti, është Kosova, sipër në veri, Serbi.

Së katërti, është jugu i Greqisë dhe iu garantoj që në aspektin e optimizmit të sistemit fizikisht, sistemi është në nivelin e tij më të mirë. Nuk ka qenë asnjëherë interkonjeksioni kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, ky është diskutim më vete.

Energjia nuk blihet me çmim të lartë, energjia, kur blihet në tregun ndërkombëtar i referohet spotit të asaj dite, për shkak sepse ne nuk kemi arritur në atë që quhet planifikim afatgjatë i blerjeve. Pse? Sepse ne varemi nga klima. Ky është problem serioz, por që duhet zgjidhur besoj me diversifikimin energjetik.

Faleminderit!

Vazhdojmë me pyetjet e tjera. Më falni, besoj se keni edhe 5 pyetje, sepse shumicën e keni përmbledhur. Kështu që keni edhe gjysmë ore kohë për t'i përmbledhur të gjitha që ne të ecim.

Anila Denaj – Zoti kryetar, pjesën e pyetjeve që kanë të bëjnë me paketën fiskale, do t'i shikojmë në orën 17:00. Kështu që do të vazhdojmë vetëm tek të ardhurat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, apo në orën 17:00?

Arben Ahmetaj – Në orën 17:00.

Anila Denaj – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Folëm për energjinë dhe sigurisht që Ministria e Energjetikës do të jetë vetë që t'i sqarojë të gjitha, edhe projeksionet, sikurse dhe të gjitha strategjitë për zhvillim dhe diversifikim të sektorit të energjisë.

Më lejoni të përmend çështjen e shëndetësisë, sepse është një nga pyetjet sa do të rritet me përqindje ndaj produktit të brendshëm bruto, sepse është shumë e rëndësishme ta themi edhe në vlerë absolute.

Sigurisht, shëndetësia merr afërsisht 3% të produktit të brendshëm bruto me një rritje të sektorit të shëndetësisë me 2,75 miliardë lekë në vitin 2020. Ku konsiston kjo rritje? Sigurisht, së pari, në shërbimet shëndetësore, të cilat lidhen me kujdesin parësor dhe spitalor. Në kujdesin parësor janë 120 qendra të reja shëndetësore. Sot jemi të gjitha koshientë që i gjithë sistemi i qendrave shëndetësore është përmirësuar në të gjithë elementet e tij, si ato strukturore, ashtu edhe në raport me pjesën e produkteve që tejçojnë, duke parashtruar edhe pjesën e rimbursimit të barnave, ku si rezultat edhe i kursimeve të realizuara nga rinegocimet, krijohet mundësia për të rimbursuar më shumë se 1 mijë pacientë se sa më parë brenda një tavani buxhetor të vendosur me ligj, i cili ruhet dhe do të vazhdojë të ruhet edhe në vijim.

Sigurisht, efektivitet të shtuar në shëndetësi do të ketë edhe shërbimi me cilësi dhe jo vetëm në kontekst marrje për numër banorësh, pasi ju e dini që një nga problematikat që ka qenë ndër vite, është lista e pritjes për disa shërbime dhe besoj se është evidente ulja e kësaj liste pritjeje, si rezultat i shërbimeve që janë realizuar me Ministrinë e Shëndetësisë në vite dhe jo vetëm këtë vit. Kjo do të vazhdojë edhe për vitin tjetër.

Për politikat mjedisore vjen një pyetje nga zonja Mesi. Sigurisht, në lidhje me politikat fiskale që u përmendën dje nga zoti Angjeli, ne duhet të mendojmë në mënyrë më strategjike në 3 vjetët e ardhshëm se si rritja ekonomike të orientohet drejt atraksionit të bizneseve, të cilat investojnë në energjinë e pastër...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, qetësi në respekt të zonjës ministre, sepse po u përgjigjet pyetjeve tuaja!

Anila Denaj – Në lidhje me rritjen ekonomike që lidhet me bizneset, të cilat sigurisht kanë në fokus të tyre ekonominë gri shoqëruar edhe me teknologjinë e shtuar, por në raport me mjedisin, besoj se janë dy elemente për t'u përmendur; nga njëra anë, nuk do të ketë elemente të ndryshuar të taksimit për vitin 2020, por do të ketë një betejë, siç është anonçuar edhe më parë, ndaj qeseve plastike, e cila do të përshkallëzohet më shumë këtë vit.

Pyetjet e zotit Sinaj kryesisht kanë të bëjnë me pjesën e TVSH-së së rimbursuar 20% me 6%, që unë do ta trajtoj në orën 17:00.

Pse nuk keni parashikuar në këtë projektbuxhet rritje të pagës minimale? Më lejoni të them se vjet u rrit me plus 8,4%. Rritja e mëtejshme mund të konsiderohet, por nuk është një kusht i përvitshëm dhe, sigurisht, do të shikohet në vitet në vijim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pjesën e skemës së fermerëve do ta trajtojmë në orën 17:00, prandaj e lashë, sepse ka të bëjë me paketën fiskale.

Shumë nga pyetjet e zonjës Mesi dhe të zonjës Gjylameti u adresuan në pyetjet që ishin në fillim në lidhje me të ardhurat. Nuk e di nëse ka ngelur diçka, zoti Lara për të ardhurat ?

Arben Ahmetaj – Në korrektesën e listës, mua më rezulton se nuk ka ngelur asgjë. Zonja Ministre, do të shtojmë vetëm dy pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se ka një...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, mund t'ia referoni sërish pyetjen?

Zonja Ministre, ju lutem!

Po, zoti Roshi.

Meqë ju nuk u përgjigjët për një nga pyetjet e zotit Roshi, po ia rijapim fjalën.

Artur Roshi – Veç kësaj të gjithë të tjerat janë integruar në përgjigjet që ka dhënë.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Artur Roshi - A ka informalitet në ekonomi për shkak të trafikeve të paligjshme, në çfarë mase mendoni se është ajo në përqindje dhe çfarë masash janë marrë për të formalizuar këtë lloj ekonomie dhe për ta ndaluar atë në të ardhmen?

Anila Denaj – Zoti Roshi, unë do t'i bëj referencë çdo treguesi sipas INSTAT-it apo një treguesi të mbështetur nga institucionet publike. Për sa kohë ky institucion nuk referon një shifër të tillë, unë nuk mundem ...

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, lufta juaj kundër informalitetit dhe trafikut të paligjshëm, siç i referohet zoti Roshi, referohet në rritjen e të ardhurave vit pas viti. Ministrja përgjigjet për mbledhjen e të ardhurave dhe mbledhja e të ardhurave ka ardhur vit pas viti në rritje.

Anila Denaj – Zoti Roshi, përgjigjen e fillova me treguesin. Treguesin, që unë mund t'i bëj referencë sa është, më duket që as ju nuk e bëni dot referencë, sepse nuk keni ku ta gjeni.

Së dyti, informaliteti (nëse ju e keni, na e thoni që ta dimë edhe ne në mënyrë që t'i referohemi dhe jemi të hapur për ta trajtuar), këtë vit në raport me biznesin, në raport me rregullat fiskale ashtu edhe me punësimin ka qenë një proces që ka marrë jo vetëm kohën e administratës, por edhe kohën time personale. Besoj se më keni parë gjatë gjithë kohës në një proces për të evidentuar dhe për të luftuar informalitetin. Nuk evidentohet informaliteti me inspektime dhe pjesëmarrje, por evidentohet me të gjithë ne, nga ju i pari, unë e dyta, për të kërkuar rregulla të pastra loje në çdo shërbim dhe në çdo kontekst marrëdhënie qoftë me kolegët, qoftë me shërbimet. Në këtë mënyrë mund ta përmirësojmë rritjen e të ardhurave për vitin 2020 edhe më shumë nga sa kemi deklaruar.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Përgjigjet për dy pyetjet e fundit i duam pasdite, sepse do të na ndihmojnë për diskutimin e buxhetit të vitit 2020.

Po i drejtohem ministres, por edhe drejtoreshës së buxhetit: Dua të më sillni buxhetin me linjën bazë (*baze line budget*), dua angazhime që ngelen në mes ose vazhdojnë të financohen, pra, dua konceptin zyrtar me shifra për çdo projekt të vitit 2018, 2019, 2020 apo angazhime të qeverisë që financohen ose jo. Kërkoj të më sillni *baze line budget* për deputetët.

E dyta, performancën e sotme të investimeve publike, ku jemi me investimet publike sot, sepse do të lidhet edhe me pyetjen që bëri zoti Roshi që na bën një *out crowding* për vitet e tjera. Pra, këto janë dy elemente shumë të rëndësishme për deputetët, sepse e kemi diskutuar edhe në komision. *Baze line budget* me projekte, angazhime dhe brenda llogarive operative, jo vetëm investimeve. Pra, çdo lloj angazhimi dhe si reflektohet diferenca në vitin 2020. Angazhimi është për ta mbaruar rrugën në vitin 2021 dhe duhen 700 milionë lekë, por financohet 300 milionë. Për të marrë një shërbim iks duhen 10 lekë, por financohet 5 lekë. Pra, kërkoj *baze line budget*, pra, buxhetin me linjë bazë, i cili është koncept teknik dhe politik bazik në hartimin e buxhetit të shtetit.

Zonja Ministre, nëse nuk arrini dot për sot, na e sillni nesër! Moza, të lutem, e duam me detaje dhe përgjegjshmëri, sepse do ta kemi në dorë për të punuar bashkë në ditët që vijnë.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu.

Sot në orën 17:00 do të rimblidhemi për paketën fiskale.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti